

Java Kulturore Kroate

17 - 20 Nëntor



17 Nëntor



ORA: 20:00

KONCERT OPERISTIK I MIQËSISË

Ky koncert bashkon artistë të shquar nga të dy vendet në një program muzikor të pasur dhe të larmishëm, duke theksuar bukurinë dhe kreativitetin e kompozitorëve kroatë. Nga Kroacia do të performojnë: Arijana Gigliani Philipp (soprano), Petra Pia Kartelo (soprano), Jakov Kalajžić (bass), Jurica Jurasić Kapur (bariton) dhe Božo Letunić (piano). Mbrëmja do të shoqërohet gjithashtu nga Kori i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, i cili do t'i bashkohet solistëve kroatë në një festë të përbashkët muzikore të miqësisë dhe harmonisë.

**TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT
DHE ANSAMBLIT POPULLOR, HOLLI KRYESOR - TIRANË**

18 Nëntor



ORA: 20:00

SHFAQJA E FILMIT "A BLUE FLOWER"

Nën regjinë e Zrinko Ogresta, filmi ndjek historinë e Mirjanës, e cila ndodhet në prag të 20-vjetorit të punës së saj dhe pritet të marrë një çmim në një ceremoni festive. Ajo që fillimisht duket si një ditë e zakonshme shndërrohet në një udhëtim emocional përmes shtresave të jetës së saj. Në Kroaci, më 18 nëntor shënohet Dita e Përkujtimit të Viktimave të Luftës për Atdheun (1991–1995), duke nderuar të gjithë ata që dhanë jetën për lirinë e vendit.

QENDRA E ARTIT "AGIMI" - TIRANË

19 Nëntor



ORA: 13:00

DITA E KRAVATËS

Kravata, simbol i identitetit kroat, vjen në Tiranë përmes një ekspozite që tregon historinë dhe zhvillimin e saj ndër shekuj. Pas hapjes së ekspozitës, 15 anëtarë të Regjimentit të Kravatës nga Zagrebi do të marshojnë në bulevardin kryesor të qytetit, të veshur me uniforma ceremoniale dhe të shoqëruar nga ritmi i daulleve, duke sjellë një atmosferë solemne dhe tradicionale në kryeqytet.

**BIBLIOTEKA KOMBËTARE,
QENDRA "SOTIR KOLEA" – TIRANË.**

**MË PAS MARSHIM DUKE FILLUAR NGA SOTIR KOLEA, TEK PEDONALJA,
TEK SHESHI SKËNDERBEJ DHE NË BULEVARDIN KRYESOR
DERI TEK SHESHI ITALIA**

20 Nëntor



ORA: 18:30

LIGJËRATË: NDËRTIMI I NJË EUROPE TË PAQES: ROLI I KROACISË

Prof. Pavo Barišić, filozof dhe akademik kroat, si dhe President i Unionit

Ndërkombëtar Panevropian, do të mbajë një ligjëratë mbi Europën si një Projekt Paqeje. Ai do të trajtojë dimensionet filozofike, politike dhe historike të Bashkimit Evropian dhe do të theksojë kontributin e Kroacisë në zhvillimin e tij.

EUROPE HOUSE - TIRANË